

FORMULARI PËR KËRKESË PËR PËLQIM MJEDISOR

Numri i lëndës			
Data e aplikimit	19-08-2025		
Emri i plotë i projektit për të cilin aplikohet	Shpejt e shpejt L.L.C. (KOSOLAR Solar Park I - Area 2) – Solar Park		
Vlera financiare investuese e projektit (në euro)	€	2,310,000.00	
Vlera e tarifës së shërbimit për Pëlqim Mjedisor (në euro)	€	1,500.00	
Dokumentet që dorëzohen bashkë me këtë kërkesë,		Po	Jo
1. Raporti i VNM-së në katër (4) kopje, i nënshkruar nga bartësi dhe hartuesi i Raportit të VNM-së (pronarit të kompanisë së licencuar dhe personave të licencuar të kompanisë) dhe një (1) kopje në formë elektronike (CD).	PO		
2. Pëlqimin e Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftimi-informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës zonale, kushtet ndërtimore	PO		
3. Çertifikata e regjistrimit të biznesit	PO		
4. Fleta Poseduese (Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme).	PO		
5. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref	PO		
6. Plani i rilevimit të terrenet nga Gjeodeti i licencuar	PO		
7. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, për rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e kërkuarit për pëlqim mjedisor	PO		
8. Dëshminë e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor;	PO		
9. Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit	PO		
10. Në rastin e objekteve për lëndë djegëse të lëngëta apo materie eksplozive : Pëlqimi nga Autoriteti kompetent për lejin e vendosjes së rezervuarëve			JO
11. Aplikuesi ofron një (1) kopje fizike apo elektronike të raportit të VNM-së për Komunën në të cilën planifikohet të realizohet projekti i cili duhet të jetë në dispozicion të publikut.	PO		
Emri dhe mbiemri i aplikuesit	Lorik Muçaj		
Kompania	Shpejt e shpejt L.L.C.		
Adresa e Kompanisë	Rr. Ana Komena, p.n., Prishtina		
Tel, fax, E-maili	046 777 977, lorik@essexperts.com & kosolar@greenartcenter.org		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

FATURË-RACUN-INVOICE

Nr.ser.-Ser.br.- Ser.no.

002097

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Waters / Departman za Zaštitu Sredine i Voda

PELQIM MJEDISOR

SAGLASNOST ZA ŽIVOTNU SREDINU

ENVIRONMENTAL CONSENT

Emri / Mbiemri
Ime / Prezime
Name / Surname

Snipejt e Shipejt LLC

Përshkrimi
Opis
Description

Pelqim Mjedisor
Solar Park - Area 2

Shuma
Iznos
Amount

€ 1500 Euro 00 Ct Data Datum Date 190825

Me fjalë
Rečima
In words

Ngjimi i pesë mijë euro

Llogaria bankare
Broj žiroračuna
Bank account

1000400070002120

Lëshuar nga
Izdato od
Issued by

MM PH

nënshkrimi dhe vula e bankës
potpis i pečat banke
bank signature and stamp

UNIREF





BANKA KOMBETARE TREGTARE

Mandati Elektronik

Përshkrimi i transaksionit

Emri i Klientit	: LORIK MUCAJ	Tipi i Veprimit	: TRNFRGN
Adresa	: RR ISA KASTRATI PN PRISHTINE 10000 KOSOVE	Numri i Klientit	: 702271691

Detajet e Veprimit

Llogaria Debituese	:	1902271691321193
Numri i Referencës	:	2523101949012002
Emri i Dërguesit	:	LORIK XHAVIT MUCAJ
Datë Valuta	:	19/08/2025
Emri i Përfituesit	:	MMPHI
Llogaria Kredituese	:	XK051000400070002120
Shuma Debituar	:	1,500.00 EUR
Shuma Kredituar	:	1,500.00 EUR
Përshkrimi	:	PAGESE 002097 AREA 2 SHPEJT E SHPEJT
Kursi i Këmbimit	:	1.00
Komisioni	:	0



Shënim: Ky mandat elektronik ka vetëm qëllim informues dhe nuk shërben si dokument i autorizuar. Në rast se informacioni nuk perputhet, në konsideratë merren të dhënat e bankës. Merrni pranë degëve të BKT-së një kopje të autorizuar të transaksioneve.

Date e Krijimit 19/08/2025 01:37:07

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PARKU I ENERGJISË DIELLORE 6 MWp (4950 kWe) -
Area 2
“Shpejt e Shpejt L.L.C.”
KOSOLAR Solar Park I
RAHOVEC



Shpejt e Shpejt L.L.C.
KOSOLAR Solar Park I

Gusht, 2025

Raport i VNM – Parku i Energjisë Diellore 6 MWp (4950kWe) “Shpejt e Shpejt L.L.C.”

Kompania ‘Shpejt e Shpejt L.L.C. – KOSOLAR Solar Park I’ me seli në Prishtinë, për kryerjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore, në Komunën e Rahovecit, autorizon z. Emrullah Spahiu, Person fizik/juridik i Licencuar për hartimin e Raporteve të VNM-së

Investitori: Shpejt e Shpejt L.L.C.

Lorik Muçaj, Drejtor ekzekutiv



Hartues i Raportit të VNM-së: Emrullah Spahiu, Person fizik/juridik i Licencuar për hartimin e Raporteve të VNM-së, Licenca nr. 38/19


Emrullah Spahiu
Licencuar për hartimin e Raportit të VNM-së
Ser. i licencës: 38/19

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT	6
2.1. RREGULLATIVA LIGJORE	6
2.2. METODOLOGJIA E PUNËS.....	7
3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT	8
3.1. POTENCIALET EKZISTUESE	8
3.2. POZITA GJEOGRAFIKE E LOKACIONIT	9
3.3. POPULLATA DHE VENDBANIMET	10
3.4. INFRASTRUKTURA EKZISTUESE	11
3.5. KUSHTET KLIMATIKE	11
3.6. HIDROGRAFIA	11
6.2.1. Ujërat Nëntokësore.....	12
6.2.2. Ujërat Termo-Minerale	Error! Bookmark not defined.
3.7. FLORA DHE FAUNA	13
3.8. NDËRTIMI GJEOLOGJIK I LOKACIONIT	14
3.9. KARAKTERISTIKAT SIZMIKE	16
3.10. EFEKTET VIZUALE (PEIZASHI)	16
3.11. AJRI	16
3.12. UJI.....	16
3.13. ZHURMA	17
3.14. NATYRA DHE BIODIVERSITETI	17
4. PËRSHKRIMI I PARKUT TË ENERGJISË DIELORE	17
4.1. PËRSHKRIMI I TEKNOLOGJISË	17
4.2. PARIMI I PUNËS DHE ELEMENTET E CENTRALIT FOTOVOLTAIK.....	18
4.3. VLERA INVESTIVE	21
5. VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....	21
5.1. NDIKIMET NË MJEDIS GJATË PËRGATITJEVE DHE NDËRTIMIT.....	22
5.2. NDIKIMET NË MJEDIS GJATË FAZËS SË OPERIMIT.....	24
5.3. NDIKIMET NË MJEDIS PAS NDERPRERJES SË SHFRYTËZIMIT.....	26
5.4. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDSHME MJEDISORE TË PROJEKTIT.....	27
6. MASAT PËR MBROJTJE TË MJEDISIT	27
6.1. MASAT E PËRGJITHSHME GJATË NDËRTIMIT	27
6.2. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT GJATË OPERIMIT	29
6.2.5. Masat për menaxhimin e mbeturinave	29
6.2.6. Masat për zbutjen e ndikimit vizual	29
6.2.7. Masat për mbrojtjen e shpendëve	30
6.3. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT PAS PËRFUNDIMIT TË PUNËS SË PARKUT TË ENERGJISË DIELORE	30
6.4. MASAT REHABILITUESE TË MJEDISIT PAS PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT	30
7. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TË MJEDISIT	31
8. PËRFUNDIM	47
9. DOKUMENTACIONI TEKNIK.....	48

1. HYRJE

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ka për qëllim të identifikojë ndikimet në mjedis të aktivitetit të ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme - Parkut të Energjisë diellore në Pallaticë, Komuna e Rehovecit.

Objekti parashikohet të ndërtohet në tokë private, në Pallaticë, zona kadastrale ZK. Rahovec përbrenda ngastrave kadastrale: P-71510057-07502-0, P-71510057-07492-0, P-71510057-07520-0, P-71510057-07495-0, P-71510057-07496-0, P-71510057-07499-0, P-71510057-07501-0, P-71510057-07519-0, P-71510057-07518-0, P-71510057-07517-0, P-71510057-07513-0, P-71510057-07514-0, P-71510057-07515-0, P-71510057-07516-0, P-71510057-07512-0, P-71510057-07493-0, P-71510057-07494-0, P-71510057-07497-0, P-71510057-07498-0, P-71510057-07505-0, P-71510057-07521-0, P-71510057-07522-0, P-71510057-07523-0, P-71510057-07525-0, dhe P-71510057-07503-0.

Fuqia e përgjithshme e instaluar e centralit parashikohet të jetë 6MWp dhe prodhimi mesatar vjetor do të jetë 8504925kWh/vit. Sipërfaqja e përgjithshme e ngastrave, ku parashikohet të ndërtohet centrali është 66,576 m²

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e Parkut të Energjisë diellore, në lokalitetin "Pallaticë", Komuna e Rahovecit, është punuar në bazë të kërkesës së Lorik Muçaj, Drejtor ekzekutiv i Kompanisë "Shpejt e Shpejt L.L.C." dhe shërben për marrjen e pëlqimit mjedisor e pastaj lejeve tjera të nevojshme për ndërtimin e Parkut të Energjisë diellore. Në raport do të analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë, në të gjitha fazat e saj dhe do të parashikohen masat e domosdoshme që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të ndërtohet Parku i Energjisë diellore.

Ndërtimi i Parkut të Energjisë me anë të paneleve diellore është në pajtueshmëri të plotë me strategjinë e Republikës së Kosovës për shfrytëzimin e burimeve alternative të energjisë, pasi që Kosova është në procesin e harmonizimit të legjislacionit me atë të EU-së në fushën e mbrojtjes së klimës si dhe në fushën e shfrytëzimit efikas të energjisë dhe promovimit të burimeve të energjisë alternative.

Qëllimi i studimit - Parku i energjisë Diellore do të ndërtohet me qëllim të prodhimit të energjise elektrike nga energjia diellore duke bërë shndërrimin e energjisë diellore në energji elektrike njëkahore përmes qelulave solare. Energjia elektrike njëkahore e prodhuar përmes paneleve diellore shndërrohet në energji elektrike alternative përmes inverterëve, e cila pastaj përmes transformatorit bartet në rrjetin e energjisë elektrike.

Përmes VNM-së do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin ku do të ndërtohet Parku i Energjisë diellore si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat tjera mjedisore të punëve, të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër.

Gjatë hartimit të Raportit të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante në mjedis që mund të paraqiten gjatë ndërtimit të Parkut të Energjisë diellore, duke mos anashkaluar edhe regjionin e gjerë. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport i VNM-së bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t'u ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis do të merret për bazë identifikimi i ndikimeve negative në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore, gjatë fazës së kryerjes së aktiviteteve prodhuese dhe pas fazës së përfundimit të aktiviteteve prodhuese.

Për hartimin e këtij raporti janë shfrytëzuar të dhëna nga burime të ndryshme, literatura ekzistuese, ueb faqja e komunës në fjalë, raportet e ndryshme mbi vlerësimin e aktiviteteve të ngjashme, dhe gjithashtu janë realizuar disa vizita në vendin ku synohet të bëhet investimi, me qëllim të njohjes me zonën, me pajisjet, objektin, procesin teknologjik dhe infrastrukturën në lokacion. Poashtu, janë shfrytëzuar edhe të dhëna nga Instituti Hidrometeorologjikë për zonën në fjalë si dhe të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit dhe materiale relevante për projekte të ngjashme.

Në terren janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është incizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti. Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme.

2. BAZA LIGJORE PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Raporti i VNM është hartuar në bazë të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 (2023), i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim të mundësojë një vlerësim të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen, me qëllim që, në kohën e duhur, të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit të vazhdueshëm i Parkut të Energjisë diellore, dhe atë:

- identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin;
- vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe
- propozimin e masave themelore për mënjanimin apo zvogëlimin e ndikimit mjedisor deri në kufijtë e lejuar.

Raporti i VNM-së përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Me rastin e hartimit të Raportit të VNM-së për Parkun e Energjisë diellore me fuqi 6 MWp (4950kWe), Në Pallaticë, Rahovec, janë marrë për bazë ligjet më të rëndësishme të zbatueshme dhe aktet tjera, si vijon:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (2023);
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022);
- Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për Mbeturina;
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110;
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233;
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11;
- Ligji për kimikate Nr. 04/L-197;
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012;

- Ligji Nr. 03/L-138, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 02/L-89 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë;
- Udhëzimi administrativ (MMPHI) Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor;
- Udhëzimi administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- Udhëzimi administrativ (QRK) – NR. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimi administrativ (QRK) – NR. 08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ Nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave;
- Udhëzimi administrativ MMPH, Nr.10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale;
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës dhe
- Udhëzimi administrativ Nr.05/13. për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave.

b) Dokumentacioni teknik

- Projekti ideor teknik për Parkun e Energjisë diellore me fuqi 6 MWp (4950kWe), Pallaticë, Rahovec, me objektet / infrastrukturën përcjellëse;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikata mbi të drejtat e pronës;
- Kopja e planit të ngastrës;
- Plani i situacionit;
- Pëlqimin e komunës ose njoftim - informatë sipas PZHK;
- Plani zhvillimor komunal - PZHK
- Informata Teknike për Kycje në Rrjet të Transmetimit të Stacionit Gjenerues me Diell Nënstacioni në RAHOVEC nga KOSTT.

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për Parkun e Energjisë diellore me fuqi 6 MWp (4950kWe), Pallaticë, Rahovec, bëhet në disa faza.

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis;
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike;

- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin e Parkut të Energjisë diellore;
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike;
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë;
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes;
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës;
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar;
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse.

c) Analiza e rrezikimit të

- njeriut,
- vlerave materiale,
- vlerave natyrore.

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura nga vlerësimi i ndikimit në mjedis në lokacionin e projektit.

Pjesë e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet vlerësimi të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që nuk ka të bëjë me ndonjë potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë terren. Për t'u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t'u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike. Rëndësia e veçantë e këtij projekti është, pos tjerash, në zhvillimin e ekonomisë komunale të Rahovecit. Një ndër prioritetet në realizimin e këtij projekti është krijimi i vendeve të reja të punës dhe furnizimi me rrymë elektrike.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimi i gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë diellore – 6MWp, me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe mënjanimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyrorë si që janë toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna.

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.5 km². Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distance rreth 45 km, në VL me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në JL me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhënë P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km . Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes : 1.Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, dhe 2.Fshati Hoqë e Madhe, Hoqe e Madhe.




Figura 1. Komuna e Rahovecit në kuadër të hartës së Republikës së Kosovës

Parku i Energjisë diellore gjendet në komunën e Rahovecit, në fshatin Pallaticë, në zonën kadastrale ZK. Rahovec: P-71510057-07502-0, P-71510057-07492-0, P-71510057-07520-0, P-71510057-07495-0, P-71510057-07496-0, P-71510057-07499-0, P-71510057-07501-0, P-71510057-07519-0, P-71510057-07518-0, P-71510057-07517-0, P-71510057-07513-0, P-71510057-07514-0, P-71510057-07515-0, P-71510057-07516-0, P-71510057-07512-0, P-71510057-07493-0, P-71510057-07494-0, P-71510057-07497-0, P-71510057-07498-0, P-71510057-07505-0, P-71510057-07521-0, P-71510057-07522-0, P-71510057-07523-0, P-71510057-07525-0, dhe P-71510057-07503-0.



Figura 2. Lokacioni i Parkut të Energjisë diellore

Ngastrat ndodhen përgjatë rrugës rrugës rajonale R117 Rahovec – Xërxe, në lokalitetin e quajtur Pallaticë. Perderisa në pjesën jugore përkufizohen me rrugën kryesore, në Veri, Perendim e Lindje, ngastrat janë përsëri të rrethuara me pronat e “Stonecastle Vineyards & Winery L.L.C.”. Qasja në ngastra është e përshtatshme dhe punët në instalimin dhe operimin e mirëmbajtjen e parkut nuk paraqesin pengesë për vendbanimet përreth.

Ngastrat janë të përshtatshme për ndërtimin e Parkut të Energjisë diellore sepse pozita gjeografike e tyre e përshtatshme mundëson periudhë kohore më të gjatë të rrezatimit dhe është në përputhje me kërkesat e investitorëve.

3.3. Popullata dhe vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, e paraqet popullata dhe demografia e saj. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar.

Në afërsi të lokacionin, ku planifikohet të ndërtohet impianti kompanis, ka pak objekte të banimit, dhe disa objekte afariste. Edhe ato janë në një distancë afërsisht 25 m nga kufiri i

ngastrave. Vendosja e paneleve do të fillojë së paku 10 m nga kufiri i ngastrës dhe do të krijohet një distancë e mjaftueshme.

3.4. Infrastruktura ekzistuese

Vendndodhja e parkut të Energjisë diellore është përgjatë të rrugës rajonale R117 Rahovec - Xërxe, dhe rrugës Rahovec - Malishevë. Infrastruktura e zhvilluar nuk do të rrezikohet nga aktiviteti i Parkut të Energjisë diellore, sepse synohet të respektohen të gjitha kriteret dhe procedurat mbizotëruese.

3.5. Kushtet klimatike

Territori ku do të ndërtohet impianti në Komunën e Rahovecit karakterizohet nga një klimë kontinentale me ndikime mesdhetare, që ofron kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe instalimeve për prodhimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme, veçanërisht energjia diellore. Temperatura mesatare vjetore është rreth 11.68°C, me verëra të nxehta dhe dimra të ftohtë. Reshjet vjetore janë mesatarisht 700 mm, me shpërndarje më të dendur gjatë stinës së pranverës dhe vjeshtës. Zona përfiton nga një nivel i lartë rrezatimi diellor, me një mesatare prej 2500 deri në 2700 orë diellore në vit, çka e bën të përshtatshme për investime në panele fotovoltaike. Poashtu erërat në këtë zonë janë të moderuara, me shpejtësi mesatare që varion nga 8.1 km/h në muajt më të qetë deri në 11.3 km/h në muajt më të erëshëm, siç është shënuar në të dhënat historike të motit për Rahovec ndaj dhe e shndërrojnë këtë lokalitet një aset të rëndësishëm për zhvillimin e projekteve të qëndrueshme energjetike fotovoltaike në territorin e komunës.

3.6. Hidrografia

Komuna e Rahovecit ndodhet në jugperëndim të Kosovës dhe përfshihet në pellgun ujëmbledhës të Drinit të Bardhë, një nga sistemet më të rëndësishme hidrografike në vend. Rrjeti hidrografik i kësaj komune përbëhet nga lumenj dhe përroska që kanë një ndikim të rëndësishëm në ekosistemin lokal, bujqësi dhe jetën e përditshme të banorëve.

Lumi i Rahovecit: Ky lumë është një nga rrjedhat kryesore ujore që përshkon territorin e komunës. Ai buron nga zonat kodrinore dhe rrjedh përmes qytetit të Rahovecit, duke ofruar ujë për nevoja bujqësore dhe duke kontribuar në peizazhin natyror të zonës.

Lumi i Remnikut: është një rrjedhë ujore me rëndësi lokale, që përshkon pjesën juglindore të komunës së Rahovecit (në afësi të parcelave të lartëpërmendura). Uji i Remnikut shfrytëzohet kryesisht për ujitjen e parcelave bujqësore dhe për qëllime të tjera bujqësore në fshatrat përreth. Në disa segmente është ndërhyrë për ta kanalizuar rrjedhën me qëllim të mbrojtjes nga erozioni dhe për të lehtësuar ujitjen.

Përroi i Fortesës: Ky përroi kalon nëpër fshatin Fortesë dhe është i njohur për rrjedhën e tij të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Ai luan një rol të rëndësishëm në ujitjen e tokave bujqësore përreth dhe në ruajtjen e biodiversitetit lokal.

Përroi i Xërxës: Duke kaluar nëpër fshatin Xërxë, ky përroi është një tjetër element i rëndësishëm i rrjetit hidrografik të komunës. Ai kontribuon në furnizimin me ujë të tokave bujqësore dhe ndihmon në mbajtjen e ekuilibrit ekologjik të zonës.

Përveç këtyre, ekzistojnë edhe rrjedha të tjera më të vogla dhe përroska që formojnë një rrjet të dendur ujërash sipërfaqësore në komunë. Këto burime ujore janë jetike për bujqësinë, veçanërisht për kultivimin e vreshtave dhe perimeve, të cilat janë të zhvilluara gjerësisht në këtë komunë.

Megjithëse reshjet vjetore janë të moderuara, me një mesatare prej rreth 707 mm, prania e këtyre burimeve ujore garanton stabilitet hidrik për tokat bujqësore. Zona ku planifikohet ndërtimi i impiantit fotovoltaik nuk ndodhet në afërsi të ndonjë trupi të përhershëm ujor, nuk paraqet rrezik për përmytje dhe nuk është pjesë e ndonjë zone të mbrojtur ekologjikisht nga aspekti hidrografik. Për këtë arsye, ndikimi i projektit në aspektin hidrologjik vlerësohet i ulët dhe i menaxhueshëm, pa pasoja të drejtpërdrejta mbi rrjetin ujor lokal apo rajonal.

6.2.1. Ujërat Nëntokësore

Ujërat nëntokësore në Komunën e Rahovecit përbëjnë një burim potencial të rëndësishëm për shfrytëzim, sidomos për nevoja të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore, që përbëjnë bazën e ekonomisë vendore. Sipas karakteristikave të terrenit dhe shtrirjes së përroskave dhe lumenjve të këtij territori, ku formacionet aluviale janë të pranishme në thellësi prej 3–10 metrash dhe me koeficient poroziteti rreth 18–22%, vlerësohet se ekzistojnë rezerva të moderuara ujore të shfrytëzueshme përmes pusetave individuale. Në disa zona, si në Opterushë, Zaqishtë dhe Retijë, burimet nëntokësore shfrytëzohen për ujitje, megjithëse pjesërisht janë jashtë funksionit. Ujërat nëntokësore gjithashtu përdoren kryesisht për pije dhe për bujqësi nga pusët familjare. Cilësia e këtyre ujërave ndikohet në mënyrë të pjesshme nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve, por ndikimi më i theksuar buron nga depërtimi i ujërave të zeza dhe mungesa e trajtimit të tyre në disa zona të komunës.




Figura 3. Rrrjedhe ujore të rajonit ku gjendet lokacioni.

3.7. Flora dhe Fauna

Në Komunën e Rahovecit, biodiversiteti është i pasur dhe i larmishëm, megjithëse studimet e detajuara për llojet bimore dhe shtazore janë të kufizuara. Në bazë të vëzhgimeve në terren dhe të dhënave ekzistuese, flora e këtij rajoni përfshin një gamë të gjerë bimësh, duke filluar nga bimët barishtore deri te shkurret dhe drurët. Në zonat bujqësore dominojnë kulturat periodike, ndërsa në zonat më të egra hasen bimë si murrizi, manaferra dhe kaça. Në Parkun Rajonal të Mirushës, i cili shtrihet pjesërisht në territorin e Rahovecit, janë identifikuar disa specie endemike dhe të rralla, duke përfshirë *Genista hassertiana*, *Aster albanicus* dhe *Centaurea kosaninii*.

Sa i përket faunës, territori i Rahovecit është habitat për një sërë specimesh shtazore. Në zonat pyjore dhe malore, si ato përreth Parkut të Mirushës, janë vërejtur gjitarë si derri i egër (*Sus scrofa*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), lepuri i egër (*Lepus europaeus*), iriqi (*Erinaceus concolor*) dhe lloje të ndryshme të brejtësve. Gjithashtu, janë raportuar raste të pranishmërisë së ujkut (*Canis lupus*) dhe maceve të egra (*Felis silvestris*). Në zonat ujore dhe pranë lumenjve, siç është lumi Drini i Bardhë, janë identifikuar lloje të ndryshme të amfibëve dhe peshqve.

Në fushën e ornitofaunës, vëzhgimet në fshatin Drenoc kanë evidentuar praninë e 76 llojeve të ndryshme të shpendëve, përfshirë bilbilat, thëllëzat e fushës dhe sorrat.

3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit

Rrethina e gjerë e lokacionit ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë diellore ëshë e ndërtuar nga këto formacione gjeologjike:

- Depozitimet e Neogjenit (Ng)
- Depozitimet e Kuaternarit (Q)
- Depozitimet e Holocenit (Qh)

Depozitimet e Kuaternarit (Q)-Këto depozitime përbëjnë formacionet më të reja dhe ndodhen kryesisht përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe në pjesët më të ulëta të terrenit.

Sedimentet e Pleistocenit (Qp) – paraqiten në formën e terracave lumore, të vendosura në të dy anët e rrjedhave. Karakterizohen nga përbërje heterogjene me zhavorr, rërë dhe argjilë me trashësi 1–7 m.

Depozitimet e Holocenit (Qh) – janë të përfaqësuara nga aluvione përgjatë lumenjve, kryesisht përbërë nga rërë dhe zhavorr.

Depozitimet e Neogjenit (Ng)

Shtrihen pjesërisht në zonën qendrore e lindore të lokacionit. Përfaqësohen nga konglomerate, rërëgure, dhe shtresa argjilore, të depozituara në mjedise ujërash të ëmbla. Këto njësi kanë trashësi të konsiderueshme (deri në 1000 m) dhe përbëjnë një substrat më të qëndrueshëm për ndërtim në krahasim me depozitet kuaternare.

Formacionet e Paleogjenit (Pg)

Të identifikuara në pjesën lindore dhe juglindore të hartës, përfaqësohen nga mergel dhe rërëgure të forta. Këto njësi kanë karakter më kompakt dhe përbëjnë bazament të përshtatshëm për vendosjen e strukturave të qëndrueshme.




Figura 4. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit.

3.9. Karakteristikat sizmike

Zona e Rahovecit ndodhet në një fushë me rrezik të moderuar deri të lartë sizmik. Bazuar në hartat e rrezikut të Kosovës, vlera e pritur e Akselerimit të Përdorur Tokësor (PGA) është 0.10–0.22 g për probabilitetin 10% brenda 50 vjetëve .

Kjo përputhet me një intensitet sizmik ekuivalent 6–7 në shkallën MMI (Merkalit të Modifikuar), ku intensitetet maksimale historike në zonat përreth kanë arritur deri në MMI VIII–IX .

3.10. Efektet vizuale (peizashi)

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin Centrali i Energjisë diellore - mjedisi.

Me këtë rast gjithësesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive. Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Centrali i Energjisë diellore në efektet vizuale nuk do të ketë ndikime negative. Do të ketë Analiza vizuale paraprake (p.sh. ZTV, fotomontazhe) për të identifikuar zonat kritike të ndikimit dhe vlerësuar sensitivitetin visual, si dhe do të behët orientimi i strukturës dhe ngjyrave neutrale të panelëve për të zvogëluar refektimin dhe përkeqësimin vizual .

3.11. Ajri

Në territorin e komunës së Rahovecit deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më i saktë i gjendjes mjedisore për lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë diellore.

Por duke marrë parasysh mungesën e aktiviteteve industriale, konfiguracionin natyror të terrenit dhe prezencën e florës dhe faunës, mund të supozojmë që cilësia e ajrit është në nivel të kënaqshëm dhe pa ndotje të dallueshme.

3.12. Uji

Ngastra ku është planifikuar të ndërtohet Centrali i Energjisë diellore nuk ka ndotës të mëdhenj potencial. Ndotja e ujit shkaktohet nga ujërat e zeza të patrajtuara, të cilat shkarkohen nga komuniteti në përrua, nga hedhja e mbeturinave nga komuniteti në brigjet e përrenjve dhe në shtretërit e tyre.

3.13. Zhurma

Nuk ka të dhëna matëse zhurme për këtë zonë specifike të Rahovecit. Bazuar në natyrën rurale dhe mungesën e burimeve të zhurmës periodike ose të përhershme (industria, trafiku i rëndë), mund të konkludohet se niveli i zhurmës është minimal dhe i pa-dëmshëm për shëndetin dhe përqendrimin e njerëzve.

3.14. Natyra dhe biodiversiteti

Monumentet Natyrore – Përgjatë territorit të Komunës së Rahovecit gjenden një sërë lokacionesh të cilat përmbajnë monumente natyrore me rëndësi të lartë ekologjike, shkencore dhe kulturore, që paraqesin veçori të rralla, estetikisht tërheqëse dhe me vlera të posaçme rekreative. Këto përfshijnë elemente të natyrës si burime ujore me karakter hidrologjik dhe relikte bimore me vlera botanike, të cilat, për shkak të rëndësisë së tyre, janë të mbrojtura në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Konservimin e Natyrës. Monumentet natyrore në këtë komunë ndahen në dy kategori kryesore:

- Monumente me karakter hidrologjik, si p.sh. burimi i fshatit Nagavc (Burimi i Çelikut), i njohur për vetitë e tij shëruese dhe përdorimin tradicional nga komuniteti;
- Monumente me karakter botanik, si p.sh. pemët shekullore në zonën e vjetër të Rahovecit apo përreth vreshtave, të cilat përfaqësojnë biodiversitetin lokal dhe ruajtjen e gjeneve të rralla vendore.

Këto monumente paraqesin potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e ekoturizmit, edukimit mjedisor dhe ruajtjes së trashëgimisë natyrore në nivel lokal dhe rajonal. Mbrojtja, menaxhimi dhe promovimi i këtyre burimeve duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), për të siguruar integritetin e tyre në politikat zhvillimore të qëndrueshme dhe në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura.

Duke qenë se çdo lloj monumenti natyror ka karakteristika të veçanta, metodologjia e mbrojtjes duhet të jetë e përshtatur sipas tipologjisë së tyre – përfshirë masa teknike, legale, edukative dhe komunitare. Krahas monumenteve tashmë të shpallura, ekzistojnë edhe zona të tjera me potencial për mbrojtje, veçanërisht në mikrozonat malore dhe përgjatë lumenjve lokalë, të cilat rekomandohet të identifikohen dhe përfshihen në hartën e ardhshme të pasurisë natyrore të mbrojtur të Rahovecit.

4. PËRSHKRIMI I PARKUT TË ENERGJISË DIELLORE

4.1. Përshkrimi i teknologjisë

Në Centralet fotovoltaike, energjia elektrike prodhohet në qelulat diellore, të cilat përbëhen nga një ose dy shtresa të materialit gjysmëpërçues. Kur rrezet e diellit shkëlqejnë në një qelulë diellore, midis këtyre shtresave krijohet një forcë elektromotore që shkakton rrjedhjen e një sasive të rrymës elektrike. Sa më i madh të jetë intensiteti i rrezatimit diellor, aq më e madhe

është rrjedha e energjisë elektrike. Materiali më i zakonshëm për prodhimin e qelulave diellore është siliciumi, i cili merret nga rëra dhe është një nga elementët më të përhapur në koren e Tokës.

Modulet fotovoltaikë janë pajisje jashtëzakonisht të besueshme, të qëndrueshme dhe të heshtura për prodhimin e energjisë elektrike. Një modul tipik fotovoltaik ka një efikasitet 15 - 20 përqind, që do të thotë se ai mund të shndërrojë në energji elektrike nga një të gjashtën deri në një të pestën e energjisë së diellit që bie mbi të.

Sistemet fotovoltaike nuk prodhojnë zhurmë, nuk kanë pjesë lëvizëse dhe nuk lëshojnë ndotës në atmosferë. Duke marrë parasysh energjinë e përdorur në prodhimin e moduleve fotovoltaike, ato prodhojnë dhjetëra herë më pak dioksid karboni për njësi të energjisë së prodhuar se sa teknologjitë e karburanteve fosile. Një modul fotovoltaik ka një jetëgjatësi mbi tridhjetë vjet dhe është një nga produktet gjysmëpërçuese më të besueshme. Sistemet fotovoltaike kërkojnë mirëmbajtje minimale. Në fund të jetës së tyre, modulet mund të riciklohen pothuajse plotësisht dhe lëndët e para përbërëse të tyre mund të ripërdoren.

4.2. Parimi i punës dhe elementet e Centralit fotovoltaik

Parimi kryesor i projektimit të një sistemi fotovoltaik është arritja e një ekspozimi sa më të lartë ndaj rrezatimit të diellit, në mënyrë që të ketë prodhim sa më të lartë të energjisë. Faktorët kryesorë që ndikojnë në prodhimin e energjisë nga sistemi solar fotovoltaik janë: niveli i rrezatimit diellor, orientimi, këndi dhe mënyra e vendosjes, temperatura e moduleve fotovoltaike, dhe eficientia e sistemit si tërësi.

Skema bazë e Centrali diellor të lidhur me rrjetin elektrik është paraqitur në Figurën 5.




Figura 5. Skema bazë e Centrali diellor të lidhur me rrjetin elektrik

Pjesët kryesore të një Centrali diellor të lidhur me rrjetin elektrik janë fusha fotovoltaike, e përbërë nga modulet fotovoltaikë të lidhura në seri (1), mbrojtja nga rrymat DC (2), shndërruesi / invertori (3), mbrojtja nga rrymat AC (4), kabllimi AC/DC (AC vijat me

ngjyrë të kuqe, DC – vijat me ngjyrë të kaltër) dhe pika e kyçjes së objektit në rrjetin elektrik (5). Energjia diellore shndërrohet drejtpërdrejt në energji elektrike njëkahore në qelulat diellore. Më tutje, tensioni njëkahor (DC) duhet të shndërrohet në tension alternativ (AC) me tension dhe frekuencë të duhur (400V, 50Hz). Shndërrimi i tensionit njëkahor në atë alternativ kryhet nga shndërruesi (invertori). Pjesa kryesore e invertorit është një urë gjysmëpërçuese e përbërë nga ndërprerës gjysmëpërçues të kontrollueshëm, të cilët ndërpresin tensionin njëkahor me një frekuencë të lartë dhe e shndërrojnë atë në tension alternativ. Tensioni alternativ më pas filtrohet dhe përcillet në rrjetin elektrik. Përveç shndërrimit të tensionit njëkahor në tension alternativ, shndërruesi kryen detyra të tjera të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit dhe përmbushjen e rregullave të rrjetit të sistemit elektroenergjetik.

Përshkrimi i Projektit:

Projekti konsiston në ndërtimin e parkut fotovoltaik me kapacitet deri në 6MWp në zonën e Pallaticës, Rahovec. Kjo do të jetë një burim energjie të qëndrueshme dhe të pastër, që do të kontribuojë në rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme në vendin tonë.

Hapësira e Zbatimit:

Zona e përcaktuar për ndërtimin e këtij parku fotovoltaik është fshati Pallaticë, zona katastrale Rahovec. Ky vendim ka qenë i bazuar në analizën e niveleve të diellit, topografisë dhe infrastrukturës lokale. Zona e përzgjedhur ofron një potencial të lartë për prodhimin e energjisë elektrike nga rreze diellore.

Objektivat e Projektit:

1. Ndërtimi i parkut fotovoltaik me kapacitet deri në 6 MWp (4950kWe).
2. Furnizimi i energjisë elektrike për komunitetin lokal dhe rrjetin e energjisë elektrike.
3. Reduktimi i ndikimit negativ të gazrave të efektit të serrë dhe përmirësimi i mjedisit lokal.
4. Krijimi i mundësive të reja të punës dhe nxitja e zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit.

Hapat Kryesorë të Projektit:

1. Hartimi i një studimi të mundësisë dhe analiza e impaktit mjedisor për të vlerësuar ndikimin e ndërtimit në mjedis dhe komunitetin.
2. Sigurimi i lejeve dhe pajisjeve të nevojshme për ndërtimin e parkut fotovoltaik.
3. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme, duke përfshirë panelët fotovoltaik, sistemin e rrjetit, dhe infrastrukturën e lidhur.
4. Testimi dhe monitorimi i performancës së sistemit për sigurimin e një funksionimi të qëndrueshëm dhe efikas.

5. Bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe komunitetin për të siguruar mbështetjen dhe përfshirjen e tyre gjatë të gjithë fazave të projektit.

Përfitimet e Projektit:

1. Sigurimi i një burimi të qëndrueshëm dhe të pastër të energjisë elektrike.
2. Reduktimi i shpenzimeve për importin e energjisë elektrike.
3. Përmirësimi i infrastrukturës dhe krijimi i mundësive të reja të punës në zonën lokale.
4. Nxitja e ndërgjegjësimit mjedisor dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit lokal.

Ky projekt synon të kontribuojë në përparimin e zhvillimit ekonomik dhe mjedisor në komunën e Rahovecit, duke krijuar një burim të qëndrueshëm të energjisë elektrike dhe duke ndikuar pozitivisht në komunitetin lokal.

Zgjidhja Teknike

1. Vendndodhja dhe Topografia:

- Zgjidhja e një terreni të përshtatshëm në Pallaticë, duke pasuar me analizën e detajuar të niveleve të diellit dhe topografisë.
- Vendorsja e panelëve fotovoltaike në një drejtim optimal për të kapur sa më shumë rreze diellore.

2. Panelët Fotovoltaike:

- Përdorimi i panelëve fotovoltaike 66HD610-630W, të avancuar dhe efikas për të maksimizuar prodhimin e energjisë.
- Instalimi i sistemit të orientuar drejt diellit dhe përdorimi i teknologjive të pastra për mirëmbajtje.

3. Infrastruktura Elektrike:

- Ndërtimi i një sistemi të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të rrjetit për transportimin e energjisë elektrike.
- Përdorimi i materialeve të cilësisë së lartë dhe teknologjive të fundit për të garantuar sigurinë dhe efikasitetin.

4. Stacioni i Konvertimit:

- Ndërtimi i një stacioni të specializuar për konvertimin e energjisë elektrike nga rryma njëkahore (DC) (nga panelët fotovoltaike) në rrymë alternative (AC) (për rrjetin e energjisë elektrike).
- Përdorimi i teknologjive moderne për monitorimin dhe menaxhimin e performancës së stacionit.

5. Sistemi i Depozitimit të Energjisë:

- Përfshirja e një sistemi të vogël të depozitimit të energjisë për të mbuluar periudhat e dobëta të dritës diellore.
- Përdorimi i baterive dhe teknologjive të avancuara të depozitimit.

6. Siguria dhe Mirëmbajtja:

- Zhvillimi i një sistemi të integruar të sigurisë për parandalimin e rreziqeve të mundshme.
- Hartimi i një plani të strukturuar të mirëmbajtjes dhe monitorimit të sistemit.

7. Përdorimi i Tokës dhe Paisjeve Ambientale:

- Minimizimi i ndikimit në mjedis dhe përdorimi i materialeve të riciklueshme.
- Përdorimi i teknologjive të zbutura për të zvogëluar ndikimin e zhurmës dhe pasigurisë për kafshët e egra.

8. Përfshirja e Komunitetit:

- Krijimi i një programi për trajnimin dhe punësimin e personelit lokal.
- Informimi dhe përfshirja e komunitetit në të gjithë fazat e projektit.

Ky dizajn synon të sigurojë një park fotovoltaik efikas dhe të qëndrueshëm në Pallaticë duke integruar teknologjitë më moderne dhe duke pasuar praktikatat më të mira në fushën e energjisë diellore.

4.3. Vlera investive

Vlera investive e Parkut për Energji Diellore 6 MWp (4950kWe) „Stone Castle Energy“ është në shumën prej rreth 2.1 Milion €.

5. VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme, të cilat janë si pasojë e aktiviteteve të ndërtimit dhe funksionimit të Parkut të energjisë diellore në këtë lokacion, tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vihet sipas një analize gjithëpërfshirëse. Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Ndikimet në mjedis mund të lajmërohen në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative në mjedis i klasifikojmë në tri periudha themelore:

- Për fazën e ndërtimit të Parkut të Energjisë diellore në këtë lokacion;
- Për fazën e funksionimit të Parkut të Energjisë diellore;
- Gjithashtu duhet paraparë ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të operimit të Parkut të Energjisë diellore.

5.1. Ndikimet në mjedis gjatë përgatitjeve dhe ndërtimit

Gjatë kësaj faze, aktivitetet shtrihen në instalimin e pajisjeve ndërtimore dhe punëve tjera deri në përfundimin e ndërtimeve, që zakonisht kalojnë pak sipërfaqen e paraparë për instalimin e paneleve solare. Punët kryesore të pritura të kësaj faze kanë të bëjnë me:

- Hapjen (gërmimin) e trasesë dhe shtrimin e rrugëve për qasje të automjeteve transportuese për bartjen e pajisjeve instaluese dhe atyre ndihmëse,
- Mijjen e kanaleve të tokës (në thellësi sipas projektit teknik) për shtrimin e kabllave,
- Zhvendosjen e dheut për përshtatjen e relievit sipas nevojës,
- Vendosjen e mbajtësve të paneleve solare, bazamentin e trafostacionit.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve do të shtohet edhe lëvizja e mjeteve të ndryshme transportuese dhe përdorimi i makinerive të ndryshme për ndërtimin e strukturave të ndryshme në zonën e instalimit. Këto aktivitete të kësaj faze do të shkaktojnë zhurmë dhe emisione të gazrave shtesë dhe varësisht nga kushtet e punës, me mundësi të emisioneve të pluhurit. Poashtu, nuk përjashtohen edhe mundësit e rrjedhave të vajrave nga makineritë dhe gjenerimi i mbeturinave të ndryshme, nëse ato nuk menaxhohen si duhet.

5.1.1. Toka

Sipas modelit të përzgjedhur për vendosjen e paneleve solare, ndikimet në tokë do të jenë të vogla, pasi që mbajtësit e paneleve janë në formë të spiraleve dhe do të futën në thellësi deri 1.60m. Mbajtëset e paneleve janë nga çeliku i zinkuar me mundësi korrozioni zero. Dheu i cili do të largohet në një anë gjatë vendosjes së kabllave elektrike dhe përcjelljen e tyre deri tek transformatori, do të kthehet prapë në vendin ku ka qenë. Pra, gjatë fazës së instalimeve të mbajtësve dhe vendosjes së paneleve solare, ndikimet në kualitetin e tokës do të jenë minimale. Sasia e dheut të gërmuar nga punimet e lartcekura duhet të sigurohet që pas vendosjes së shtyllave të paneleve të mbulohet sipërfaqja e degraduar për kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme. Sasia e dheut të mbetur të përdoret për tamponimin e rrugëve që përgatiten apo të vendoset në ato lokacione që vlerësohet se nuk ka ndikime negative në mjedis dhe në marrëveshje me strukturat udhëheqëse lokale.

5.1.2. Mbeturinat

Gjatë fazës së ndërtimit dhe instalimit të mbajtësve dhe paneleve solare, sasia e mbeturinave do të jetë e papërfillshme. Do të krijohen mbeturina jo të rrezikshme nga materialet ndërtimore, ambalazhimet e ndryshme, mbeturinat komunale që janë si pasojë e punimeve të zhvilluara dhe pranisë së personelit në punishten ndërtimore. Poashtu, gjatë ndërtimit krijohet edhe një sasi e caktuar e mbeturinave të rrezikshme ku gjatë shfrytëzimit të automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimor mund të vjen deri te derdhjet e pakontrolluara të derivateve dhe vajrave motorike në tokë e pastaj edhe në ujërat nën tokësore. Këto derdhje mund të bëhen nga mirëmbajtja jo e rregullt e automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimor apo nga moskujdesi i faktorit njeri. Hedhja e

mbeturinave të krijuara pa kontroll në lokacionin e punishtes do të ketë pasoja negative për mjedisin e lokacionit. Për të gjitha llojet e mbeturinave që krijohen gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të energjisë diellore duhet të veprohet në pajtueshmëri me Ligjin për Mbeturinat Nr.08/L-071(2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina dhe të gjitha nën akteve të këtij ligji.

5.1.3. Ajri

Në fazën e ndërtimit të Parkut të energjisë diellore, deri të ndikimet në ajër mund të vjen si pasojë e lëshuarjes së materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimor që sipas Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 (2022), konsiderohen si burime lëvizëse të emisioneve në ajër. Në hapësirat për rreth lokacionit si ndikim në ajër konsiderohet edhe pluhuri, i cili ngritet gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjes së kanaleve, shtruarjes me dhe të platove, rrugëve etj, pastaj lëvizjes e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës. Emisioni i pluhurit gjatë fazës së ndërtimit ndryshon nga dita në ditë, që do të thotë se varet nga intensiteti dhe lloji i punëve që zhvillohen. Ndikimet e emisionit të pluhurit janë të kufizuara dhe vlerësohen pa pasoja afatgjate në kualitetin e ajrit.

5.1.4. Ujërat

Sipërfaqja ku do të ndërtohet Parku i energjisë, e ka një porozitet të theksuar dhe në rastet e reshjeve atmosferike prania e ndotjeve nga kjo sipërfaqe mund të bartet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të shkaktojë efekte mjedisore. Gjatë ndërtimit të Parkut të Energjisë diellore nevojitet të përgatitet një sipërfaqe në formë platoje, ku do të vendoset makineria punuese me të gjithë mekanizmat përcjellës, në mënyrë që të pengohet derdhja e ndonjë sasive të vajrave apo karburanteve dhe të arrijë në rrjedhjet nëntokësore të ujërave. Krahassuar me të gjitha llojet e burimeve të energjisë, energjia që përfitohet nga parqet diellore konsumon më së paku ujë për kW/h krahasuar me të gjitha llojet e energjisë, psh: 1kW/h nga parqet solare shpenzon rreth 0.1 lit, ndërsa nga termocentralet rreth 75 lit për kW/h. Pra në këtë aspekt, ky projekt del të jetë miqësor me mjedisin, ujërat. Trupi uhor, përroska e ujërave sipërfaqësore gjendet në pjesën lindore të ngastrës, gjendet në distancë rreth 50 m nga panelet diellore, dhe kjo distancë duhet të respektohet, dhe përroska nuk ndikohet fare nga ky projekt.

5.1.5. Zhurma

Gjatë fazës së ndërtimit vjen deri të rritja e përkohshme e zhurmës nga funksionimi i automjeteve transportues dhe mekanizmave ndërtimor. Si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda ndërtimore, në fazën e ndërtimit të paneleve diellore, mund të vjen deri të ngritja e zhurmës, e cila në lokacionet e punës gjatë orarit të punës (8-18) mund të jetë prej 55 - 65 dB, në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen nga Zhurma Ligji për mbrojtjen nga zhurma Nr. 02/L-102 dhe Direktivën 2000/14UE për emisionin e zhurmës nga pajisjet e ndryshme që përdoren jashtë objekteve.

5.1.6. Flora dhe fauna

Gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë diellore, mund të vjen deri te ndikimet në botën bimore dhe shtazore nga funksionimi i mekanizmave të rëndë, punëve të dheut, bota bimore do të shkatërrohet e cila do të mbillet pas përfundimit të fazës së ndërtimit, ngritjes së pluhurit, deponimi i përkohshëm i materialit ndërtimor dhe pajisjeve montazh, gjatë realizimit të aktivitetit të ndërtimit. Ndikimet negative janë më të shprehura në ato lloje të faunës që jetojnë në tokë, sepse me ndërtimin e rrugëve të kalueshme dhe sipërfaqeve për parkim dhe servisim të automjeteve dhe deponim të materialeve drejtpërdrejt ndikon në zvogëlimin e banimit të tyre. Supozohet se nga lokacioni ku ndërtohet Parku i paneleve të energjisë diellore, të gjitha ato lloje të faunës që pengohen (ndikohen) nga aktivitetet që zhvillohen në punishte do të largohen në periferi të lokacionit dhe pas përfundimit të punimeve një pjesë e tyre gjatë kërkimit të ushqimit apo lëvizjeve të tyre përsëri do të kthehet në këtë lokacion. Pas fazës së ndërtimit nuk do të ketë rrethoja (pengesa) në punishte ashtu që të gjitha rrugët e migracionit të faunës nëpër lokacionin e Parkut të energjisë diellore do të jenë të lira. Ndërtimi i Parkut të energjisë diellore, në hapësirat përreth nuk ka ndikim në florë dhe faunë sepse kemi të bëjmë me një energji të pastër pa emisione operacionale dhe me ndikime minimale në mjedis. Në territorin e ngushtë, ku do të vendosen panelet e energjisë diellore nuk kemi ndonjë vlerë natyrore që cenohet nga aktiviteti i këtij projekti, qoftë gjatë fazës së ndërtimit apo operimit të tij.

5.2. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit

5.2.1. Ndikimet nga pajisjet e instaluar

Këtu merren parasysh ndikimet e shkaktuara nga vetë prezenca e pajisjeve. Si rezultat i ndërtimit të bazamenteve të pajisjeve, shtrimit të rrugëve, e aktiviteteve tjera operuese - vlerësohet se sipërfaqja e ngjeshur dhe mbuluar e tokës janë të vogla (rreth 5%) krahasuar me sipërfaqet e përgjithshme të zënë nga panelet solare. Në rastin kur si bazament për panele diellore përdoren shtylla të ngulitura në tokë, siç është rasti i këtij projekti, atëherë kjo sipërfaqe nuk kalon 2%. Sipërfaqja e tokës e mbuluar nga panelet diellore, me përjashtim të një sipërfaqe që rreth 8%, në përgjithësi përfshihen nga rrezatimi i diellit. Sipërfaqja pra që mund të mbetet në mënyrë të vazhdueshme nën hije, dhe që është prapë në varshmëri të lartësi së paneleve, është shumë e vogël. Në skajet e paneleve, si rezultat i të reshurave, mund të krijohen kanale të vogla dhe të paraqesin mundësi erozioni të tokës. Kjo varet shumë nga pjerrtësia e terrenit dhe lloji i tokës. Në rastin konkret, kur sipërfaqja është relativisht e rrafshët dhe toka ka përbërje të konsiderueshme. Sa i përket ndikimeve në botën shtazore nga prezenca e paneleve diellore, ekzistojnë vlerësime se ndikimet mund të jenë relativisht të vogla, pozitive apo negative, në varshmëri të llojeve të shtazëve. Në këtë rast toka është para këtij projekti është e kufizuar (rrethuar) me rrethoja që pamundësojnë qasjen e kafshëve të ndryshme. Mund të kenë qasje vetëm shpendët fluturuese. Edhe pse projektet e ndërtimit gjithmonë shkaktojnë shqetësim të florës dhe faunës ekzistuese, me parqe solare është rast

për të përmirësuar kualitetin e habitatit për lloje të ndryshme të bimëve, apo edhe duke krijuar habitate të reja.

5.2.2. Reflektimi i dritës

Parku i energjisë diellore përdor rrezatimin e diellit për prodhimin e energjisë, për këtë arsye transmissioni dhe absorbimi i rrezeve të diellit nga aspekti teknik rritet përderisa rrezatimi reduktohet. Kjo arrihet duke instaluar shtresa antirefleksive në qelulat diellore dhe duke vendosur qelqe ballore speciale. Megjithatë, vlerësohet se deri në 5% e dritës mund të reflektohet. Për shkak të këtij reflektimi, modulet solare, në një mes natyror me vegjetacion, paraqiten si objekte më të ndriçuara. Gjatë rënies së thellë të diellit (këndi i rënies nën 40%), paraqiten refleksionet në mënyrë të shtuar, mirëpo ky reflektim kryesisht shpërndahet me ndihmën e qelqeve ballore. Në këtë rast reflektimet paraqiten në pjesën perëndimore dhe lindore të panellave. Mirëpo, ky refleksion i shpërndarë vlerësohet të humb efektin vetëm në disa dm 54 distancë nga panellat, dhe më këtë nuk paraqet ndonjë ndikim në mirëqenien e njerëzve (në këtë rast banuesve më të afërt).

5.2.3. Pasqyrimi

Sipërfaqet pasqyruese reflektojnë objektet (fotografinë) përreth. Strukturat e habitateve të reflektuara mund të mashtrojnë shpezët (p.sh. zogjtë) duke iu krijuar imazhet e hapësirave jetësore dhe në këtë mënyrë duke joshur dhe paraqitur rrezik për ato. Kjo para së gjithash mund të ndodhë në lokacionet me prezencë dhe mundësi të reflektimit. Mirëpo ekzistojnë edhe studime të cilat tregojnë se për një grup zogjesh panelet diellore mund të ndikojnë pozitivisht, duke iu ofruar strehim dhe biotope ushqimi kryesisht në sezonin e dimrit.

5.2.4. Peizazhi

Lokacioni ku planifikohet të ndërtohet parku i energjisë diellore është lokacion me një peizazh homogjen në cilin nuk ka vegjetacion të ultë që mundë të pranojë një përbërje të re me ndërtimin e centralit të energjisë diellore pa ndërrime të theksuara. Në fokus do të jetë mjaftë atraktive ndërtimi i centralit të energjisë diellore mbi vegjetacionin e pjesës së rrafshët dhe uniforme. Sipas të gjitha vlerësimeve paraprake që i përkasin ndikimeve vizuale janë pozitive për lokacionin ku planifikohet të ndërtohet centrali i energjisë diellore.

5.2.5. Fushat elektrike dhe magnetike

Si prodhues të mundshëm të rrezatimeve mund janë panelet solare, sistemi i kabllave, invertori dhe transformatori. Fusha magnetike e krijuar nga rryma njekahore (e prodhuar nga qelulat solare), janë aq të ulëta sa në një distancë prej vetëm 50 cm nga panellat janë të barabarta me fushën magnetike natyrore. Po ashtu edhe kabllo prodhojnë fusha magnetike dhe elektrike të niveleve shumë të ulte dhe vetëm në zonën e ngushtë mes kabllave dhe që vlerësohen si jo problematike. Invertorët prodhojnë fusha alternative magnetike dhe forca e rrezatimit është në varshmëri të rrezatimit diellor. Zakonisht invertorët ndërtohen në shtëpiza metali, të cilat ofrojnë një barrierë të konsiderueshme të rrezatimit. Pasi që edhe ashtu vetëm

fusha alternative magnetike të vogla krijohen dhe po ashtu nuk paraqet një vend me nevojën për të qëndruar gjatë afër, atëherë edhe nuk llogaritet si me ndikim mjedisor. Dërgimi i rrymës elektrike në rrjet kalon përmes një transformatori, i cili transformon rrymën e një tensioni të ultë në atë të mesëm. Fushat maksimale të prodhuara nga këta transformator arrijnë pas pak metra vlerat e kufizuara.

5.2.6. Efektet vizuale dhe zhurma

Edhe pse panelet solare mjedisin, në pamje të parë mund të paraqesin një prishje të kualitetit estetik, megjithatë deri më tani nuk njihen konflikte të theksuara në aspektin e prishjes së balancit natyror. Për komunitetin, falë pozicionit të lokacionit dhe madhësisë së paneleve këto panela do të jenë pak të ekspozuara ndaj tyre. Ato do të jenë të ekspozuara vetëm për ata të cilët kanë pamje nga distanca. Sipas analizave të rezultateve të llogaritura tregon se niveli i zhurmës që lajmërohet në rrethinë si pasojë e funksionimit të paneleve solare është e papërfillshme dhe shumë më e ultë se normat maksimale të lejuara për intervalet e punës gjatë ditës (55 - 60 dB) dhe natës (40 - 50 dB).

5.2.7. Ndikimet në faunë

Gjatë fazës së shfrytëzimit të paneleve diellore, sipërfaqet në hapësirën ku do të ndërtohen panelet diellore, mund të shfrytëzohen për kullosa sepse panelet Diellore do të vendosen në shtylla dhe nuk pengojnë blegtorinë gjatë kullotjes. Gjatë fazës së shfrytëzimit ndikimi i paneleve diellore në botën shtazore është relativisht i vogël për arsye se sipërfaqet do të jenë të lira dhe të mbjellura me barë, përpos atje ku janë të vendosura shtyllat, prandaj në këto sipërfaqe të lira, mund të zhvillohet bota shtazore. Ndikime negative nga panelet diellore, mund të ketë në shpezët, mirëpo me kalimin e kohës edhe shpezët do t'i përshtatën punës së paneleve diellore. Ndikimi i paneleve diellore në shpezët mund të shikohet: si ndikim direkt rreziku nga ndeshja e tyre në panelet diellore dhe si ndikim indirekt nga ndikimet e zhurmës dhe ato vizuale, që mund të ndikojë në ndërrimin e lokacionit. Në hapësirën e paneleve diellore ndikimi do të jetë shumë i vogël nëse përfshihen këto kritere, të cilat do t'u përmbahet Kompania. Kriteret janë: Lidhja e kabllave nën tokë është më e dobishme sepse shpezët nuk mund të përdorin si vend pushim gjatë fluturimit, si në rastin nëse kabllo do të ishin të vendosura me shtylla dhe shpezët mund ta shfrytëzonin si vendpushim. Ndikim tjetër në botën e shpezëve do të ishte nëse panelet diellore ndërtohen në vend shtegtimin e shpezëve. Mirëpo, sa i përket shpezëve shtegtar ato fluturojnë larg mbi lartësitë e paneleve diellore.

5.3. Ndikimet në mjedis pas ndërprerjes së shfrytëzimit

Ndikimet e mundshme pas ndërprerjes së shfrytëzimit të paneleve diellore, veprimi i çmontimit dhe largimit të pjesëve të çmontuara është relativisht i thjeshtë dhe lokacioni mund të sanohet, të rehabilitohet duke ju kthyer tokës funksioni primar, apo të ridestinohet për qëllime tjera biznesore.

5.4. Përshkrimi i pasojave të mundshme mjedisore të projektit

Ndikimet mjedisore të mundshme nga ushtrimi i aktivitetit të Parkut të energjisë diellore, pritet të jenë në masë që nuk tejkalojnë kufijtë e lejuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Megjithatë, janë analizuar ndikimet specifike dhe në bazë të shkallës së mundshme të ndikimit, propozohen masat përkatëse për zvogëlimin e mëtejshëm të ndikimeve në mjedis.

5.4.1. Rreziqet e mundshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga fatkeqësitë ose katastrofat

Gjatë operimit të Parkut të energjisë diellore, ekziston mundësia e zjarreve, shpërthimeve ekcesiale, rrjedhjes së vajrave dhe karburanteve nga makineritë punuese, etj. Prandaj, është e nevojshme që të merren masa për parandalimin dhe sanimin e ndotjes sipas metodave adekuatë në parandalimin e këtyre rasteve dhe metodave përkatëse për sanimin dhe rehabilitimin e pasojave, nëse këto ndodhin. Masat përgatitore dhe masat për eliminimin e pasojave (EPA) - analiza e rrezikshmërisë bëhet në tri faza: identifikimi i rrezikut, analiza e pasojave dhe vlerësimi i rrezikut. Për rastet e rrezikut nga zjarret, nevojiten pajisje në dispozicion për shuarjen e zjarreve lokale eventuale dhe infrastrukturë e rregullt - qasje e lehtë e mjeteve emergjente të ndërhyrjes së shpejtë, zjarrfikësit e të tjera.

5.4.2. Ndikimet e mundshme në trashëgiminë kulturore

Sipas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruara në terren, në lokacionin e ngushtë, ku do të ndërtohet Parku i Energjisë diellore, nuk kemi monumente të trashëgimisë kulturore, historike e natyrore, të cilat eventualisht do të ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë së tij. Nëse eventualisht, gjatë fazës së ndërtimit, punëkryesi has në artefakte, objekte të rëndësishme arkeologjike apo objekte që përmbajnë rëndësi kulturore, këshillohet që të rrethojë (sigurojë) objektin dhe të njoftojë menjëherë autoritetet relevante komunale dhe qendrore.

6. MASAT PËR MBROJTJE TË MJEDISIT

Masat e mbrojtjes së mjedisit që duhet të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë diellore, kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve në mjedis për shkak të rritjes së qarkullimit, përdorimit të mekanizmave të rëndë ndërtimor, gërmimeve të dheut dhe aktivitete tjera gjatë ndërtimit. Në vijim janë paraqitur masat e mbrojtjes së mjedisit gjatë fazës së ndërtimit.

6.1. Masat e përgjithshme gjatë ndërtimit

Gjatë ekzekutimit të punëve të dheut nevojitet të largohet shtresa sipërfaqësore dhe veçmas të deponohet e të mos ndotet dhe pas përfundimit të punimeve të mbulohen sipërfaqet e

degraduara. Bartësi i projektit duhet të sigurojë që ekzekutimi i punimeve të bëhet me mekanizmat ndërtimor që janë teknikisht në rregull, duke iu përmbajtur dokumenteve projektuese dhe respektimit të rregullave të ndërtimit. Të gjitha sipërfaqet që janë shfrytëzuar për nevojat e ndërtimit duhet të sanohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme. Aktiviteti i zhvilluar gjatë ndërtimit duhet të ekzekutohet në atë mënyrë që të mos e pengojë qarkullimin normal të komunitetit. Automjetet transportuese duhet t'i plotësojnë kushtet sipas rregullores mbi kontrollin teknik.

6.1.1. Masat e mbrojtjes nga zhurma dhe gazrat e lëshuara

Kryesi i punëve duhet të sigurojë që ndërtimi i Parkut të Energjisë diellore të bëhet me pajisje ndërtimore që janë teknikisht në rregull, që do të thotë se emisioni i zhurmës dhe lirim i gazeve të jetë sa më i vogël i mundshëm, në kufijtë e lejueshmërisë sipas kërkesave ligjore. Punët që bëhen nën zhurmë të lartë duhet të zhvillohen gjatë ditës, pos në raste specifike kur këtë e kërkon teknologjia e punës, mund të zhvillohen edhe gjatë natës.

6.1.2. Masat e mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësore

Rezervoarët ose fuqitë ku mbahen karburantet për automjetet dhe mekanizmat ndërtimor punues, duhet të jenë të sigurtë ose të vendosen ashtu që në asnjë mënyrë të mos vjen deri derdhja e derivateve në tokë. Servisimi i mekanizmave nuk preferohet të bëhet në punishte apo në sipërfaqet shërbyese por duhet të bëhet në serviset e autorizuara për to. Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë. Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vendpunishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet. Në punishte duhet të ketë material (pluhur druri) që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet menjëherë për pastrim. Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme, të cilat mbeturina do t'i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura. Vendi ku deponohen derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar duhet të thuret me mur statik si dhe platoja (dysHEMEJA) të betonohet. Të gjitha mbeturinat e krijuara duhet të mblidhen dhe të vendosen jashtë punishtes kurse me ato mbeturina duhet të veprohet sipas rregullave të Ligjit për mbeturinat, të shënuar më lartë. Pas kryerjes së orarit të punës, makinat ngarkuese dhe transportuese duhet të parkohen në vendin e caktuar enkas për to. Për nevojat e personelit punues të vendosen tualetet - kabínat e lëvizshme.

6.1.3. Masat e përkujdesjes për materialin tepriçë

Materiali nga gërmimi i dheut që i plotëson kushtet për përgatitjen e sipërfaqeve shërbyese dhe rrugëve kaluese duhet të shfrytëzohet për ato qëllime. Materiali i gërmuar në vendin e gërmimit duhet të imtësohet e pastaj të transportohet në vendin ku do të shfrytëzohet. Materiali tepriçë, i cili duhet të largohet nga lokacioni, duhet që në marrëveshje me

komunitetin lokal të Rahovecit, të transportohet në lokacionet ku kryen ndonjë shërbim apo vendoset diku ku nuk degradon mjedisin

6.2. Masat e mbrojtjes së mjedisit gjatë operimit

Edhe pse ndikimet në mjedis vlerësohen të jenë minimale gjatë fazës së operimit, megjithatë shtrohet nevoja e disa nga masave, të cilat evitojnë ndotjet potenciale apo minimizojnë ato.

6.2.2. Masat e mbrojtjes së llojeve bimore dhe shtazore

Ekzekutimi i punëve instaluese duhet të bëhet në atë mënyrë që pamja natyrore ekzistuese e lokacionit përreth të mos ndryshojë, ose të ndryshojnë sa me pak të jetë e mundur. Të bëhet rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara dhe sipërfaqet rehabilituara të gjelbërohen duke iu përshtatur mjedisit rrethues. Pas fazës së ndërtimit në, të gjitha rrugët e migracionit të faunës nëpër lokacionin e Parkut të Energjisë diellore duhet të jenë të lira. Ndërtimi i Parkut të energjisë diellore, në hapësirat përreth nuk ka ndikim në florë dhe faunë sepse kemi të bëjmë me një energji të pastër me zero emisione operacionale dhe me ndikime minimale në mjedis.

6.2.3. Masat e mbrojtjes së dheut dhe ujit

Me rastin e pastrimit eventuel të paneleve diellore, edhe pse supozohet se ato mund të jenë të rralla - në rastet kur mungojnë të reshurat e shiut, duhet pasur kujdes që të shfrytëzohet vetëm uji pa ndonjë agjent shtesë. Nëse vjen deri te nevoja për servisimin e paneleve solare atëherë ajo duhet të bëhet në sipërfaqet shërbyese për servisim. Të gjitha mbeturinat e krijuara gjatë servisimit, pas përfundimit të punëve duhet të largohen, mbeturinat nuk guxojnë të mbesin në lokacionin e paneleve solare. Mbeturinat duhet të barten në lokacionet e parapara apo të lejuara në nivel komune apo në deponinë regjionale.

6.2.4. Masat për menaxhimin e mbeturinave

Investitori obligohet që mbetjet dhe pjesët e ndërruara të kthehen në riciklim. Menaxhimi i mbeturinave duhet të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Mbeturinat Nr.08/L071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Kompania duhet të klasifikojë dhe të dërgojë mbeturinat në kompani përkatëse, të specializuara për këtë qëllim. Mbeturinat të cilat gjenerohen në këtë kompleks, grumbullohen nga ana e operatorit dhe klasifikohen sipas llojit dhe përbërjes së tyre. Mbeturinat të cilat janë të përdorshme klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të dedikuar për to, kurse mbeturinat e papërdorshme i shiten kompanive të licencuara për veprimtarinë e grumbullimit të metaleve mbeturinë, për grumbullimin e vajrave, plastikës, etj. Mbeturinat komunale deponohen në kontejnerë, të cilët pastaj nga kompanitë e licencuara, barten në deponitë regjionale për trajtimin e tyre të mëtejme.

6.2.5. Masat për zbutjen e ndikimit vizual

Për zvogëlimin e ndikimit vizual, investitori do të këshillohet për mbjelljen e drunjve në hapësirat për rreth fushës solare në distanca që nuk krijojnë hije për panelet solare. Drunjat (bimësia) e mbjellur duhet të jenë të përshtatur me kushtet natyrore të zonës. Kjo do të ndikojë pozitivisht në pengimin e ekspozimit vizual për komunitetin e kësaj zone.

6.2.6. Masat për mbrojtjen e shpendëve

Meqenëse panelet solare nuk do të ndërtohen në lartësi të mëdha, ato pritet të kenë ndikime negative të mëdha në zogj. Megjithatë, investitori obligohet që të respektojë Direktivën për ruajtjen e zogjve të egër 79/409/EC. Qëllimi i kësaj Direktive është që të sigurohet mbrojtja, menaxhimi, dhe kontrollimi i zogjve të egër dhe foleve dhe vendbanimeve të tyre brenda Unionit Evropian. Kjo shërben si siguri që të gjithë zogjtë e egër të pranojnë mbrojtje të nevojshme nga asgjësimi i tyre. Lidhur me Traktatin, Kosova duhet të implementojë Nenin 4 (2) kur traktati të hyjë në fuqi. Rezultatet e monitorimit nga fillimi i funksionimit të Parkut të Energjisë diellore do të paraqesin një bazë themelore për vendimin se a do të ketë nevojë të ndërmerren masa shtesë për mbrojtje në formë të instalimit të ndonjë pajisje të caktuar.

6.3. Masat e mbrojtjes së mjedisit pas përfundimit të punës së Parkut të Energjisë diellore

Sipas prospekteve nga shumë prodhues të paneleve diellore, shfrytëzimi i tyre mund të zgjasë deri rreth 30 vite. Pas kësaj periudhe, nga investitori varet se a do të të vazhdohet me prodhimin e energjisë diellore duke bërë zëvendësimin me panele diellore të reja apo panelet diellore do të largohen përfundimisht. Në rast se bëhet largimi i paneleve diellore, veprimi i çmontimit dhe largimit të pjesëve të çmontuara është relativisht i thjeshtë dhe lokacioni mund të sanohet. Në atë rast duhet të përgatitet raporti për mbrojtjen e mjedisit, përmes të cilit qartë duhet të definohet ndikimi në mjedis dhe përshkruhen masat e nevojshme që duhet të ndërmerren. Largimi i paneleve diellore duhet të bëhet ashtu që të çmontohen të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike dhe varësisht prej gjendjes së tyre, të dërgohen për riciklim në qendrat e licencuara për riciklim të metaleve apo të ripërdoren. Kabllot elektrike duhet të nxirren nga toka dhe pastaj duhet të bëhet rrafshimi i hapësirave të degraduara dhe bëhet mbjellja me bar apo kulturë tjetër në varshmëri nga gjendja në terren. Pjesët nga çmontimi i paneleve diellore duhet të trajtohen, deponohen dhe transportohen vetëm nga operatorët dhe personat e licencuar. Gjatë largimit të paneleve diellore duhet të merren të gjitha masat për mbrojtjen nga ndikimet negative në mjedis, të cilat janë marrë gjatë ndërtimit.

6.4. Masat rehabilituese të mjedisit pas përfundimit të projektit

Pas përfundimit të aktivitetit, objektet ekzistuese duhet të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponinë regjionale. Të gjitha mbetjet nga proceset për riciklimin e mbeturinave të qelqit, metalit, plastikës dhe prodhimin e produkteve të tjera - mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve 63 të mbetura në sipërfaqet e lokacionit, si dhe shtresa e dheut të kontaminuar

duhet të largohen. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Përmes rikultivimit, sipërfaqeve të degraduara, prapë do t'iu kthehet funksioni i tyre paraprak, në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe do të mbjellen me bimësi që kultivohen në rrethinën e lokalitetit dhe të kthehen në gjendje të pranueshme mjedisore.

7. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TË MJEDISIT

Plan i Menaxhimit Mjedisor (PMM) synon të sigurojë zbatimin e masave zbutëse dhe monitoruese të nevojshme për të zvogëluar dhe kontrolluar ndikimet e ndryshme mjedisore dhe sociale të lidhura me zbatimin e projektit të propozuar. Objektivat kryesore të PMM janë përmbledhur më poshtë:

- Minimizimi i çdo ndikimi negativ mjedisor, social dhe shëndetësor që rezulton nga aktivitetet e projektit;
- Kryerja e të gjitha aktiviteteve të projektit në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, kushtet e lejeve dhe praktikatat e mira;
- Sigurimi që të adresohen të gjitha shqetësimet e palëve të interesuara.

Në përgjithësi, ky PMM dokumenton çështjet kryesore të mbrojtjes së mjedisit dhe çështjet sociale, veprimet që duhen ndërmarrë për t'i adresuar ato në mënyrë adekuate, si dhe orarin dhe personin/njësine përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin. Me zbatimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor mbrojtja maksimale ndaj mjedisit dhe njerëzve do të sigurohet në nivel të kënaqshëm. PMM është pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Gjatë fazës së ndërtimit

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
Cilësia e ajrit	Emetimi i ndotësve për shkak të djegies dhe emetimeve të krijuara shkarkimit, të krijuara nga pajisjet e ndërtimit, gjeneratorët, automjetet dhe trafiku i projektit Gjenerimi i pluhurit gjatë punimeve të ndërtimit dhe lëvizjes së automjeteve.	Përkeqësimi i cilësisë së ajrit të ambientit për shkak të emetimeve të ndotësve	- Zhvillimi i PMMN (Plani i Menaxhimit të Mjedisit të Ndërtimit), i cili do të specifikojë masat e duhura për menaxhimin e pastrimit, gjërmimit dhe aktiviteteve të ndërtimit për të minimizuar gjenerimin e pluhurit - Ujta e shpejtësisë në rrugët e pashtuara dhe marra e masave të tjera sipas nevojës për të zvogëluar emetimet nëse ndodh emetimi intensiv i pluhurit, derisa të vendosen spërkatjet e ujit ose masat e tjera zbutëse. - Spërkatja e rregullte sheshit të ndërtimit dhe rrugëve hyrëse gjatë sezonit të thatë do të zbatohet si një masë për të shtypur pluhurin - Shpejtësia e automjeteve do të kufizohet në 20 km/orë në vendet e ndërtimit dhe rrugët hyrëse. Mjetet që shpërndajnë materiale do të mbulohen. - Mbyllja dhe mbulimi i stoqeve të materialeve me pluhur gjatë ruajtjes në depo; - Të gjitha makineritë dhe pajisjet e ndërtimit do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe nuk do të lihen në punë kur nuk janë në përdorim. - Përdorimi i lëndëve djegëse të standardizuara për makineri dhe automjete transporti; - Shmangia e aktiviteteve që prodhojnë pluhur gjatë periudhave të erërave të forta. - Asnjë djegie e asnjë materiali kudo në kantieret e ndërtimit - Punëtorët duhet të mbrohen nga ndikimet e pluhurit dhe emetimeve, për shembull përmes kërkesave për sigurimin e maskave të pluhurit kur punojnë pranë aktiviteteve që krijojnë pluhur.	Kontraktori Mbikqyrësi Stafi i komunës

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
Dheu (toka)	Gërmimet për themelet, mbushja dhe ndërtimi i rrugëve hyrëse nëse është e nevojshme.	Prishja e strukturës së shtresës së tokës	- Aktivitetet e ndërtimit do të kufizohen brenda kufirit të projektit të propozuar dhe nuk do të ndryshojnë përdorimin e tokës në zonat ngjitur; - Rrugët hyrëse tashmë ekzistuese do të përdoren sa më shumë që të jetë e mundur gjatë aktiviteteve të ndërtimit. Të gjitha makineritë e ndërtimit dhe automjetet e transportit do të përdorin rrugë hyrëse të miratuara; - Minimizimi i heqjes së shtresës së tokës dhe kufizimi vetëm në ato zona ku është e nevojshme; - Heqja dhe ruajtja e shtresës së sipërme të tokës pjellore, e ndjekur nga ri-kultivimi dhe restaurimi i tokës pas zbatimit të punimeve; - Depot do të mbulohen në mënyrë të përshtatshme për të zvogëluar humbjen e tokës si rezultat i erozionit të shkaktuar nga era ose uji; - Rekomandohet të rritet bari nën panelet diellore për të shmangur erozionin e tokës; - Për të kontrolluar erozionin e tokës, ujërat rrjedhëse sipërfaqësore duhet të mbledhet nga të gjitha zonat e punës dhe të orientohen në kanale kullimi për të kufizuar përqendrimin e prurjeve. - Kanalet e kullimit do të ndërtohen në përputhje me kushtet topografike të Zonës së Projektit nëse është e nevojshme; - Pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore, toka e përdorur për objekte të përkohshme do të restaurohet në masën e mundshme.	Mbikqyrësi Stafi i komunës
	Derdhja ose rrjedhja e vajrave/ lëndëve djegëse nga automjetet e ndërtimit dhe	Ndotja e tokave	- Automjetet dhe pajisjet e ndërtimit do të servisoohen rregullisht. Servisimi dhe pastrimi i makinerive të ndërtimit dhe automjeteve transportuese nuk do të bëhet në vendin e ndërtimit	

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndlikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
	makineritë e tjera, ruajtja jo e duhur e vajrave/ karburanteve të mbeturinave dhe kimikateve të tjera dhe menaxhimi i dobët i mbeturinave		- Karburanti, vajrat dhe vajrat e përdorur nuk duhet të mbahen në vendin e ndërtimit. Nëse është e nevojshme, ato duhet të ruhen në një mënyrë në të cilën ata nuk do të vijnë në kontakt me mjedisin (në fuqi dhe tanke të mbyllura, të vendosura në një kuti betoni të armuar me një hapësirë mbajtëse); - Çdo kimikat i derdhur do të mbliqet menjëherë dhe do të asgjësohet në përputhje me Planin e Parandalimit - Kontraktuesi do të përgatisë udhëzime dhe procedura për veprimet e menjëhershme të pastrimit pas çdo derdhjeje të naftës, karburantit ose kimikateve. Derdhjet e pastruara të naftës, karburantit ose kimikateve do të trajtohen nga kompanitë e specializuara - Kontraktuesi do të zbatojë një program trajnimi për të njohur stafin me procedurat dhe praktikatat e urgjencës që lidhen me ngjarjet e kontaminimit; - Kontraktuesi duhet të sigurojë që të ketë në dispozicion një enë të posaçme për aktivitetet e pastrimit emergjent në rast të derdhjes së kimikateve/vajit; - Për nevojat sanitare të punëtorëve do të përdoren tualete të lëvizshme dhe do të mirëmbahen rregullisht nga një kompani e autorizuar.	
Peizazhi dhe aspektet vizuale	Magazhimi i përkohshëm i materialit, makinerive, rrugëve hyrëse të përkohshme, ndërtimi i impiantit FV	Ndryshim i përkohshëm në peizazh dhe ndërhyrje vizuale	- Mirëmbajtja e kantierit në një gjendje të rregullt; - Zbatimi i menaxhimit të mirë të ndërtimit dhe pastrimit për të kontrolluar aktivitetet dhe për të ruajtur zona të pastra pune (kjo do të arrihet përmes zhvillimit të Projektit); - Sigurimi i konsultimeve të vazhdueshme me komunitetet lokale gjatë gjithë periudhës së ndërtimit.	Kontraktori Mbikqyrësi
Zhurma	Funksionimi me pajisje, Aktiviteti i heqjes së	Telashi i zhurmës	- Planifikimi i aktivitetëve të punës për të minimizuar zhurmën e emetuar (përsa i përket kohës dhe intensitetit);	Kontraktori Mbikqyrësi

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
	shtreses së dheut, Lëvizja e automjeteve të ndërtimit, Ndërtimi i rrugës së hyrjes		- Kufizimi i aktiviteteve të ndërtimit në orët e ditës (ora 8 e mëngjesit - 5 pasdite); - Mirëmbajtja e pajisjeve dhe monitorimi i emetimeve të zhurmës, të menaxhuara përmes zhvillimit të projektit - Plani për mbrojtjen e punëtorëve; - Kontraktuesi do të kufizojë boshatisjen e motorëve kur nuk janë në përdorim për të zvogëluar kontributin e tij në emetimet e zhurmës; - Kufizimi i shpejtësisë së automjeteve në rrugë të pashtuara për transportin e materialeve; - Informimi i popullatës vendase për aktivitetet e planifikuara në kantierin e ndërtimit.	Staff i komunës
Trafiku	Krijimi i trafikut nga aktivitetet e ndërtimit	Komuniteti dhe siguria e fuqisë punëtoare dhe qarkullimi lokal i trafikut	- Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut në Ndërtim (PNMT); - Sinjalizimi i duhur dhe shenjat e sigurisë në komunikacion të vendosen në rrugët hyrëse; - Trajnimi i shoferëve në sigurinë rrugore dhe kodin e mirësjelljes; - Shqyrtimi i punës graduale për të siguruar ruajtjen e aksesit lokal; - Vendosija e kufijve të shpejtësisë; - Mirëmbajtja e automjeteve dhe pajisjeve të ndërtimit dhe përfshirja e detajeve mbi inspektimet; - Monitorimi dhe vlerësimi i trafikut dhe incidenteve të transportit; - Zbatimi i përmirësimeve të rrugëve aty ku është e nevojshme (riparimi ose rivendosja e rrjetit rrugor nëse dëmtohen nga automjetet e Projektit); - Sigurimi që të gjithë kamionët dhe automjetet të operohen nga operatorë të licencuar; - Prania e flamurit në hyrje dhe dalje të vendit të projektit në mënyrë që të kontrollojë lëvizjen e automjeteve dhe kamionëve	Kontraktori Mbikqyrësi Staff i komunës

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
Menaxhimi i mbeturinave	Aktivitetet e përgjithshme të ndërtimit, Mbeturinat e krijuara nga fuqia punëtore,	Ndikimi vizual i mbeturinave. Ndikimi në tokë dhe ujërat nëntokësore nga menaxhimi / ruajtja e dobët e mbeturinave sanitare dhe të rrezikshme. Vëllimet e panevojshme të dërguara në deponi përmes mungesës së ripërdorimit dhe ricklimit	- Identifikimi i llojeve të ndryshme të mbeturinave në vendin e ndërtimit (tokë, letër dhe dollap; paketime plastike, dru, ushqim, etj.); - Klasifikimi i mbeturinave sipas Listës së Mbetjeve; - Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për fazën e ndërtimit; - Kontraktimi me kompanitë e autorizuar për grumbullimin dhe menaxhimin e mëtejshëm të llojeve të ndryshme të mbeturinave; - Kontraktuesi do të përzgjedhë dhe do të hedhë përkohësisht llojet e ndryshme të mbeturinave, të tilla si materiale ndërtimi të riciklueshme jo të rrezikshme, plastikë, letër, për të lehtësuar asgjësimin e duhur; - Mbeturinat e rrezikshme duhet të mblihen veçmas dhe grumbulluesi dhe transportuesi i autorizuar duhet të nënkontraktohet për transportin dhe përfundimisht hedhjen e mbeturinave të rrezikshme; - Nafta e mbetur e gjeneruar nga gjeneratorët dhe makineritë e ndërtimit dhe automjetet transportuese do të ruhen në enë të mbyllura, dhe një mbajtës dytësor të përshtatshëm të betonit të armuar i aftë të përmbajë 110 % të rezervuarit më të madh që do të sigurohet - Kontraktuesi duhet të sigurojë koshat e mbeturinave brenda vendit të ndërtimit në mënyrë që të parandalohet hedhjen e mbeturinave në zonën e projektit dhe zonat përreth; - Shmangia e furnizimit me karburant në vend për të parandaluar derdhjen e naftës; - Magazinimi i duhur i paneleve PV të thyer/të dëmtuar dhe identifikimi i objekteve të licencuara për depozitim;	Kontraktori Mbikqyrësi Stafi i komunës

Parametri	Cështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
Uji	Konsumimi i ujit gjatë ndërtimit, Pastrimi i tokës në vendet e ndërtimit dhe gjatë shtrimit të rrugëve të hyrjes	Ndikimi i mundshëm në ujërat	- Magazinimi dhe asgjësimi me përgjegjësi i rrjedhjeve të lëngshme siç janë ujërat e zera nga punëtorët; - Përzgjedhja, ripërdorimi dhe, aty ku është e mundur, riciklimi i mbeturinave; - Mbulimi i mbeturinave të ngurta gjatë transportit për të shmangur shpërndarjen e mbeturinave. - Përdorimi i arsyeshëm i ujit për spërkatje në rrugët e klasifikuara të hyrjes kur është e nevojshme, për të zvogëluar emetimet e pluhurit gjatë fazës së ndërtimit; - Sasitë maksimale të ujit nëntokësor të përdorur të përcaktohen sipas hulumtimit të akuiferit; - Leja për përdorimin e puseve të merret nga autoriteti rregullator; - Matës për rrjedhjet e ujit të instalohen në puse për të monitoruar sasitë e ujit abstrakt; - Mbrojtja e tokës nga ndotja do të mbrojtë edhe ujërat nëntokësore nga ndotja. Masat zbutëse për mbrojtjen e tokës dhe zbatimin e tyre vlen edhe për mbrojtjen e ujërave nëntokësore.	Kontraktori Mbikqyrësi Stafi i komunës
Biodiversiteti (Flora dhe Fauna)		Ndikimi i mundshëm në florën dhe faunën lokale	- Të sigurojë zbatimin e masave të përshtatshme për menaxhimin e aktivitetëve të pastrimit dhe gërmimit të vendit, menaxhimin e tokës dhe mbeturinave, si dhe për infrastrukturën e lidhur (rrugët hyrëse, etj); - Minimizimi i pastrimit të bimësisë vetëm në zonat e kërkuara; - Aktivitetet që gjenerojnë zhurmë duhet të planifikohen vetëm gjatë ditës; - Lëvizja e automjeteve të ndërtimit dhe transportit duhet të kufizohet në shtigje të dedikuara për të minimizuar çdo dëm për gjitarët e vegjël pranë vendit të propozuar.	Kontraktori Stafi i komunës

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
Trashëgimia kulturore	Nuk ka objekte të njohura të mundshme në zonën e Projektit me rëndësi kulturore ose arkeologjike	Dëme të mundshme ndaj trashëgimisë kulturore, të cilat janë zbuluar rishtas gjatë punimeve tokësore të ndërtimit	- Fragmentimi i habitatit duhet të minimizohet; - Ndallimi i rreptë duhet të zbatohet në kapjen, gjuetinë ose dëmtimin e kafshëve të egra brenda nënkontraktorëve dhe duhet të sjellë një klauzolë ndëshkimi sipas marrëveshjeve kontraktuale; - Djegia ose groposja e rrjedhjeve të krijuara të mbeturinave duhet të jetë absolutisht e ndaluar.	
Shëndeti dhe siguria në punë	Potenciali i ekspozimit ndaj ngjarjeve të sigurisë të tilla si pengimi, puna në lartësi, zjarri nga punët e nxehta, pirja e duhanit, dështimi në instalimet elektrike, implantet dhe automjetet e lëvizshme dhe goditjet elektrike	Ekspozimi ndaj ngjarjeve të shëndetit dhe sigurisë gjatë aktivitetëve të ndërtimit	- Vlerësimi i rrezikut - o Siguria personale; - o Siguria e kantierit; - o Gjurmimi i tokës; - o Pastrimi përfundimtar. - Instalimi i një gardhi të përshtatshëm sigurie rreth vendit të ndërtimit, shenja paralajmëruese në hyrje të vendit për të informuar njerëzit në lidhje me Projektin dhe rreziqet që lidhen me hyrjen, hyrjen e ndaluar të personave të papunësuar; - Kufizimi i qasjes në zonat e ndërtimit të projektit; - Trajnimi për procedurat e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë të Punëtorëve. Duhet të angazhohen persona me përvojë, të kualifikuar dhe të licencuar në mënyrë të përshtatshme dhe gjithashtu do të marrin trajnime për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;	Kontraktori

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
			- Sigurohet që të gjithë punëtorët e ekspozuar ndaj një rreziku të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e mundshme; - Zhvillimi i një plani të reagimit emergjent dhe trajnimi i personelit mbi veprimet që duhen ndërmarrë në situata rreziku; - Disponueshmëria e pajisjeve mbrojtëse personale (veshje mbrojtëse, syze, doreza, çizme, maska çizme gome, pantallona të gjera pune me ngjyra të ndezura të pajisura me shirita reflektues të dritës, helmata sigurie, pajisje gome ose plastike (fishesë, lopatë, të tjera) për personelin sipas nevojës; - Sigurimi i ndihmës së parë mjekësore në vend dhe sigurimit mjekësor për punëtorët në vendin e ndërtimit; - Përdorimi i një tualeti portativ që do të pastrohet rregullisht në vendin e ndërtimit; - Sigurimi që elementët e projektit (panelet PV, bazat, zyrat, nënstacionet, etj.) janë projektuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në lidhje me rreziqet natyrore, veçanërisht sigurinë sizmike; - Kryerja e mirëmbajtjes së rregullt të pajisjeve; - Krijimi i një sistemi për të paralajmëruar punëtorët në vend. Ky mund të jetë alarmi i zjarrit i përkohshëm ose i përhershëm; - Fikësit e zjarrit duhet të vendosen në pikat e identifikuara të zjarrit rreth vendit. Fikësit duhet të jenë të përshtatshëm me natyrën e zjarrit të mundshëm; - Përgjigja e evakuimit emergjent do të përgatitet nga kontraktuesi dhe stafi përkatës do të trajnohet; - Pajisjet elektrike duhet të jenë të sigurta dhe të mirëmbajtura siç duhet; - Vetëm personat e autorizuar kompetent do të kryejnë mirëmbajtje në pajisjet elektrike;	

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
Përdorimi i tokës	Toka e ndarë nga pronari privat dhe shndërrimi nga qëllimet bujqësore në industriale.	Ndikimet në mjetet e jetesës - humbja e mundshme e të ardhurave, Rreziku i erozionit dhe rrëshqitjes së tokës	- Pajisjet e përshtatshme mbrojtëse personale (PPM) për punimet elektrike duhet t'i sigurohen të gjithë personelit të përfshirë në detyra; - Kompletet i ndihmës së parë me fashë ngjitëse, pomadë antibiotike, peceta antiseptike, aspirina, dorashka jo latex, gërhërë, termometër, etj. do të vihen në dispozicion nga Kontraktuesi në vend; - Sigurimi i informacion mbi datat e fillimit dhe mbarimit të punimeve dhe qasjen në trafik brenda zonës së ndërtimit përmes radios/stacionit televiziv lokal/gazetës lokale/uebfaqes së Komunës së Rahovecit.	Kontraktori Stafi i komunës
